

VENDIM
Nr.209, datë 16.4.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.300, DATË 12.5.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGESËN E VLERËS SË TRUALLIT TË SHOQËRIVE
HUAMARRËSE, PËR NDËRTIMIN E APARTAMENTEVE PËR KREDITORË, QË KANË
HUMBUR BANESAT NGA RËNIA E SKEMAVE PIRAMIDALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 15 të ligjit nr.8386, datë 30.7.1998 “Për mënyrën dhe procedurën e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe neneve të 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.300, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:
Në pikën 2, shifra “...24 360 m²...” bëhet “... 20 360 m²...”.
2. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano